



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA KRUJË
KËSHILLI BASHKIAK KRUJE

V E N D I M

Nr. 42, datë 30.04.2018

PËR
“NJË SHTESE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.4 DATË 02.02.2018
“PËR SISTEMIN TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË KRUJE”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), VKM nr.132 date 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.4 datë 02.02.2018, “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kruje për vitin 2018” , pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Tatim Taksave , me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kruje, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë një shtese në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.4 datë 02.02.2018 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Kruje për vitin 2018” , për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa” si vijon:
Tabela1: Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave për qëllime banimim referuar aneksit 1,2 të VKM 132, date 07.03.2018 që do të përdoren për llogaritjen e vlerës së pasurisë, sipas njesive.

	Bashkia	Cmimi mesatar referues/m2
1	Njesia Administrative Kruje	48.500 lek/m2
2	Njesia Administrative Fushe- Kruje	51.000 leke/m2
3	Njesia Administrative Nikel	33.150 leke/m2
4	Njesia Administrative Bubq	33150 leke/m2
5	Njesia Administrative Thumane	33.150 leke/m2
6	Njesia Administrative Cudhi	31.525 leke/m2

Tabela 2 : Vlera e takses per m2 ndertese qe perdoret per qellime baninimi e llogaritur sipas metodologjise se percaktuar ne Vkm nr 132 date 07.03.2018, referuar ankseve 1,2 te kesaj VKM, dhe percaktimeve ne vkb nr 4.date 02.02.2018.

Shkalla e takses 0.05%

	Bashkia Kruje	Cm.mesatar referues	Taksa per m2
1	<i>Njesia Administrative Kruje</i>	48.500 lek/m2	24,25 leke
2	<i>Njesia Administrative Fushe-Kruje</i>	51.000	25,5 leke
3	<i>Njesia Administrative Nikel</i>	33.150	16,575 leke
4	<i>Njesia Administrative Bubq</i>	33.150	16,575 leke
5	<i>Njesia Administrative Thumane</i>	33.150	16,575 leke
6	<i>Njesia Administrative Cudhi</i>	31.525	15.76 leke

Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar, çmimi për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë.

Gjate verifikimeve ne terren nëse nuk sigurojnë informacione lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vetëvlerësimin e ndërtesës/njesisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren, si me poshte

-Sipërfaqja e prezumuar Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;

b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të ndryshuar.

Tabela 3 : Vlera e takses per m2 ndertese qe perdoret per veprimtari ekonomike e llogaritur sipas metodologjise se percaktuar ne Vkm nr 132 date 07.03.2018, referuar ankseve 1,2 te kesaj VKM, dhe percaktimeve ne vkb nr 4.date 02.02.2018.

Nr rendor	Lloji I veprimtarise	Niveli cmimi referues	Cmimi referues		Shkalla e takses Ne %	Niveli baze I takses leke/m2
			Zona	Vlera l/m2		
1	Njesi tregtimi dhe sherbimi	150% e cmimit te banesave	Kruje	72750	0.2	145.5
			F-Kruje	76500		153

	Per parkime te mbuluar dhe bodrume	70% e cmimit te baneses	Kruje	33950	0.2	67.9
			F-Kruje	35700		71.4
3	Per parkime te hapura	30% e cmimit baneses	Kruje	14550	0.2	29.1
			F-Kruje	15300		30.6
4	Per veprimtari industriale	50% e cmimit te baneses	Kruje	24250	0.2	48.5
			F-Kruje	25500		51
5	Per veprimtari bujqesore dhe blektorale	30% e cmimit te baneses	Kruje	14550	0.2	29.1
			F-kruje	15300		30.6

Ndryshimi i nivelit baze së taksës Rritje/Zbritje në % si me poshte te miratuara me VKB nr 4 date 02.02.2018 :

Ndertesa per Veprimtari prodhuese Tregti dhe Sherbime:

Ndertesa per veprimtari prodhuese , tregti dhe sherbime, Biznes i Vogel vendosi: niveli baze (+10%)

Ndertesa per veprimtari prodhuese , tregti dhe sherbime, Biznes i Madh vendosi: niveli baze(+15%)

Ndertesa per veprimtari (prodhuese e sherbime artizanale) , Biznes i Madh vendosi .niveli baze(+30%)

Ndertesa per veprimtari prodhuese,tregti dhe sherbime Tatimpaguesit e medhenj Biznese Vip : vendosi : niveli baze (+30%)

Ndertesa per veprimtari prodhuese , tregti dhe sherbime, qe nuk jane ne shfrytezim perkohesisht vendosi: niveli baze -30% .

2. Efektet për këte takse fillojnë nga data 1 prill 2018.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Tatim Taksave ne Bashkine Kruje.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefektura e Qarkut Durrës.

